

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt. 03.10.2022	
Zyra e pranimit	Nr. I protokollit
308	01-442/A



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

KODI I ETIKËS PËR STUDENTËT E UNVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, 2022



Në mbështetje të nenit 144, paragrafi 1.6 të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2022, miraton:

KODIN E ETIKËS PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Neni 1 Qëllimi

1. Kodi i Etikës ka për qëllim të përcaktojë rregullat e sjelljes dhe standardet etike të veprimt, për studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.
2. Qëllimi i Kodit të Etikës për studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, synon të promovojë dhe avancojë vlerat e studentëve dhe Universitetit.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky Kod i Etikës zbatohet për studentët e rregullt, me korrespondencë, studentët vizitorë, si dhe për çdo student që është i regjistruar në studime të të gjitha niveleve apo në programet certifikuese të ofruara nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren.
2. Ky Kod i Etikës përcakton standardet e sjelljes etike të studentëve të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren si dhe llojet e sjelljeve joetike nga ana e studentëve.

Neni 3 Shkurtesat dhe përkufizimet

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj Rregulloreje, përkufizimet e mëposhtme kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. Universiteti-Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - 1.2. Studentët-Studentët e rregullt dhe me korrespondencë të Universitetit, përfshirë edhe studentët ndërkombëtarë si dhe ata vizitorë.

Neni 4 Standardet e sjelljes etike të studentëve

1. Universiteti synon të ofrojë një ambient të përshtatshëm për zhvillim akademik, si dhe trajtim të barabartë, korrekt e me dinjitet për të gjithë studentët.
2. Studentët duhet të sillen sipas standardeve të larta etike, duke vepruar me kujdes dhe qëllimin që ta mbrojë Universitetin, pronën dhe imazhin e Universitetit, personelin e Universitetit, punën e vet shkencore dhe hulumtuese si dhe vlerat e Universitetit.



3. Studentët janë të obliguar që të respektojnë aktet e Universitetit, përfshirë Statutin dhe të gjitha rregulloret e tjera të miratuara nga Universiteti.
4. Studentët në ambientet e Universitetit duhet të sillen në atë mënyrë që të mos pengojnë punën e personelit të Universitetit dhe të vet studentëve.

Neni 5

Parimet dhe standardet e sjelljes të studentëve

1. Studentët duhet të sillen, sipas këtij Kodi të Etikës dhe të bazuar në parimet si në vijim:
 - a) Parimin e ligjshmërisë;
 - b) Parimin e transparencës;
 - c) Parimin e ndershmërisë dhe integritetit;
 - d) Parimin e respektit reciprok dhe kolegjal;
 - e) Parimin e ndershmërisë akademike;
 - f) Parimin e lirisë akademike dhe hulumtimit;
 - g) Parimin e respektimit të të drejtave të personelit dhe të kolegëve studentë;
 - h) Parimin e respektimit të rregulloreve dhe vendimeve të Universitetit.
2. Studentët e Universitetit, me rastin e veprimeve të tyre, duhet t'i kenë parasysh parimet e përcaktuara në këtë Kod dhe veprimet e tyre maksimalisht t'i orientojnë mbi bazën e këtyre parimeve.
3. Veprimet apo mosveprimet që konsiderohen shkelje të Kodit Etik të Universitetit, përfshijnë ato veprime që çenojnë parimet si në vijim:
 - a) Cënimin e integritetit personal;
 - b) Mohimin e lirisë së shprehjes;
 - c) Cënimin e privatësisë;
 - d) Cënimin e integritetit të Universitetit;
 - e) Cënimin e integritetit të personelit akademik dhe joakademik;
 - f) Mos tolerancën;
 - g) Cënimin e pronësisë intelektuale;
 - h) Keqpërdorimin e mirëbesimit financiar;
 - i) Cënimin e rregullave bibliotekare dhe laboratorike;
 - j) Cënimin e infrastrukturës universitare;
 - k) Sjellja e pahijshme dhe joprofesionale në proceset akademike si: mësim, provim, praktikë profesionale e të ngjashme;



Neni 6 Obligimet e studentëve

1. Studentët në ambientet e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, sipas këtij Kodi Etik obligohen:
 - a) Të zbatojnë orarin e mësimit dhe t’u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - b) Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambientet e institucionit, që nënkupton një veshje të përshtatshme për institucione edukativo-arsimore;
 - c) Të përdorin fjalor të përshtatshëm, sipas normave të etikës, moralit dhe të mirësjelljes;
 - d) Të respektojnë personelin akademik, ndihmës mësimor shkencor dhe personelin administrativ, studentët dhe rregullat e mësimit;
 - e) Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese ose ngacmuese ndaj personelit akademik, personelit administrativ ose studentëve të tjerë, në mjediset e Universitetit;
 - f) Të mos ofrojnë në asnjë formë, privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa ose dhurime, vet ose nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, ose favorizime të tjera, të cilat personelit të Universitetit mund t’i kryejnë për shkak të detyrës;
 - g) Të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangien nga shlyerja e detyrimeve mësimore;
 - h) Të mos konsumojnë pije alkoolike, duhan ose substanca të ndaluara në ambientet e institucionit;
 - i) Të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit ose provimit;
 - j) Studenti i cili përfshihet në një veprim të ndaluar ose thyerje të normave në fuqi i cili rezulton në prishjen e orës së mësimit mund të urdhërohet nga mësimdhënësi të largohet nga salla e mësimit për periudhën e mbetur të orës së mësimit. Për përjashtime më të gjata, si pasojë e prishjes së orës së mësimit, duhet të merren vendime me shkrim nga organet përkatëse;
 - k) Të mbajnë me vete përgjatë procesit mësimor ID-in e studentit të dhënë nga Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, apo letërnjoftim dhe ta paraqesin ose të dorëzojnë atë sipas një kërkesë të bazuar nga anëtarët e stafit akademik ose administrativ të Universitetit.

2. Studentët e Universitetit i përmbushin obligimet e tyre, duke pasur parasysh këtë Kod të Etikës, Statutin si dhe aktet e tjera në fuqi të Universitetit.

Neni 7 Të drejtat e studentëve

1. Si studentë të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, gëzojnë të drejtat si vijojnë:



- a) Çdo student ka të drejtën të jetë i lirë nga diskriminimi racor, fetar, etnik, përkatësia politike, mosha, gjinia dhe aftësive të kufizuara.
 - b) Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikat e universitetit, nuk pengon mbarëvajtjen e punëve në Universitet dhe respekton të drejtat e të tjerëve;
 - c) Studentët janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda Universitetit. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në zbatim me rregulloren e Universitetit. Organizatat e njohura dhe të pranura mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e Universitetit sipas politikave dhe procedurave administrative të Universitetit.
 - d) Studentët kanë të drejtë dhe përgjegjësi të raportojnë, në mirëbesim dhe pa frikë hakmarrjeje, çdo shkelje të këtij Kodi ose politike akademike dhe administrative të Universitetit tek drejtuesit akademik ose administrativ të Universitetit.
2. Studentët e Universitetit i realizojnë të drejtat e tyre, duke pasur parasysh këtë Kod të Etikës, Statutin si dhe aktet e tjera në fuqi të Universitetit.

Neni 8

Sjelljet jo etike dhe shkeljet e rënda të studentëve

1. Sjelljet jo etike dhe të ndaluara të studentëve sipas këtij Kodi, që konsiderohen edhe si shkelje të rënda përfshijnë veprimet në vijim:
 - 1.1. Ndërhyrje ose përçarje që pengon, dëmton misionin dhe imazhin e Universitetit si dhe proceset ose funksionet që shkelin të drejtat e të tjerëve. Sjellje të tilla përfshijnë: pushtimi i çfarëdo ndërtese të Universitetit ose pasurisë ose pjesë të tyre pa autorizimin e Universitetit; bllokimi i hyrjes ose daljes së ndonjë ndërtese të Universitetit; vendosjen e zjarrit ose me ndonjë mjet tjetër, duke dëmtuar ndërtesë, pronën ose pasurinë universitare;
 - 1.2. Përdorimi, shpërndarja e substancave narkotike ose të rrezikshme. Universiteti ndalon mbajtjen, përdorimin, shitjen ose shpërndarjen e substancave të paligjshme ose substancave të kontrolluara;
 - 1.3. Sjellja e çrregullt, abuzive, dhe të dhunshme që nënkupton: Çdo përpjekje ose kërcënim i paramenduar me synimin lëndimin e personit tjetër, së bashku me aftësinë e dukshme për ta bërë këtë është e ndaluar. Një sjellje e çrregullt mund të kryhet pa prekur, goditur, ose bërë dëm trupor. Në varësi të rrethanave një faktor lehtësues për këtë sjellje mund të jetë vetëmbrojtja.
 - 1.4. Kërcënim për ushtrimin e dhunës ose ushtrimi i cilësdo formë të dhunës;
 - 1.5. Zbatimi i programeve ose aktiviteteve që përbëjnë shkelje të interesave shtetërore dhe politikave të Universitetit. Studentët dhe përfaqësuesit e tyre nuk kanë të drejtë të lidhin marrëveshje të dëmshme dhe të paligjshme me palët e



treta në emër të Universitetit, të cilat mund t'i shkaktojnë dëme financiare, materiale dhe që ta dëmtojnë imazhin e Universitetit;

- 1.6. Është i ndaluar falsifikimi ose manipulimi i shkresave dhe dokumenteve zyrtare të Universitetit, përdorimi i dokumenteve dhe të dhënave zyrtare të Universitetit për qëllime keqinterpretimi. Përdorimi i telekomunikacionit, rrjetit të të dhënave ose ndonjë pajisje elektronike në pronësi dhe administrim të Universitetit për qëllime të paligjshme/të pahijshme, në shkelje të rregullores, politikave të Universitetit ose ligjeve është e ndaluar;
- 1.7. Kopjimi apo tentimi për të kopjuar gjatë provimeve, kollokfiumeve, testeve ose formave tjera të vlerësimit; Kopjimin e përgjigjeve nga një student tjetër gjatë provimit; komunikimin e paautorizuar me të tjerët gjatë një provimi; lejimin e një studenti tjetër të kopjojë përgjigjet; zëvendësimin e një personi tjetër ose përdorimin e një tjetri si zëvendësues gjatë një provimi; programimi paraprak i një makine llogaritëse ose pajisjeve të tjera elektronike që mbajnë përgjigje ose informacion të paautorizuar për provim; përdorimin e materialeve të paautorizuara, përgjigjeve të parapërgatitura, shënimeve të shkruara, ose informacionit të fshehur gjatë një provimi; lejimin e të tjerëve të bëjnë për ta një detyrë ose pjesën e një detyre (psh. detyrën e grupit), përfshirë përdorimin e shërbimit komercial të punimeve (blerjen e tyre); dorëzimin e së njëjtës detyrë në më shumë se një lëndë pa miratimin paraprak të të gjithë mësimmësuesve të përfshirë.
- 1.8. Përdorimi ose posedimi i mjeteve të pa lejuara në provime, kollokfiume ose formave tjera të vlerësimit, si për shembull, përdorimi i paautorizuar i telefonit, kalkulatorit, librave, kopjeve të ndryshme e të ngjashme;
- 1.9. Hyrja në kollokfiume, provime, teste apo forma tjera të vlerësimit, në emër të dikujt tjetër si dhe përgatitja e punimit të diplomës, seminareve dhe detyrave për studentë të tjerë;
- 1.10. Fotografimi i testit dhe shpërndarja e testit në rrjete sociale apo në çfarëdo mënyre tjetër;
- 1.11. Ofrimi ose dhënia e ryshfetit personelit të Universitetit ose atyre që mbajnë pozita drejtuese;
- 1.12. Përvetësimi i paautorizuar i aseteve ose shërbimeve brenda Universitetit është i ndaluar.
- 1.13. Mbajtja pa leje e çfarëdo lloj arme (armë zjarri, lëndë shpërthyes, thika, etj) ose çfarëdo mjeti që përbën rrezik për mirëqenien e anëtarëve të komunitetit universitar është i ndaluar.
- 1.14. Prishja, dëmtimi ose shkatërrimi i pronës publike ose private janë të ndaluara. Nuk lejohet hyrja ose përdorimi i objekteve pronë e Universitetit, ose pronave në ruajtje ose kontroll të Universitetit, përfshirë infrastrukturën, pajisjet dhe inventarin për një qëllim të pahijshëm, pa autorizimin e duhur, ose duke ndihmuar të tjerët të veprojnë kështu;
- 1.15. Dëshmia e rreme ose fshehja e evidencave përballë organeve kolegjiale ose anëtarëve të personelit të Universitetit. Raportimi i rremë i ndonjë situatë tjetër



rreziku: Njohja dhe mosraportimi i një ngjarje/akti që rrezikon personelin e Universitetit; Ndryshimin e informacionit ose të dhënave dhe paraqitjen e tyre si të ligjshme; dhënien e informacionit të rremë/mashtroes për një mësimdhënës ose zyrtar të Universitetit; sabotimin ose vjedhjen e detyrës, librit, punimit, shënimeve, eksperimentit, projektit software ose hardware elektronik të një personi tjetër; shitjen, shpërndarjen, postimin në website ose botimin e shënimeve të ligjëratave, ushtrimeve, regjistrimeve, ose informacioneve tjera të dhëna nga një mësimdhënës, ose përdorimi i tyre për qëllime komerciale, pa lejen e mësimdhënësit; falsifikimin e nënshkrimit në një letër rekomandimi ose ndonjë dokumenti tjetër të një mësimdhënësi; vënien e emrit të një personi në provimin ose detyrën e një personi tjetër; ndryshimin e një provimi ose detyre të vlerësuar më parë me qëllim për të fituar pikë në një proces rivlerësimi.

- 1.16. Ngacmime të çdo lloji, përfshirë edhe ngacmimet seksuale ndaj personelit akademik dhe administrativ ose studentëve të Universitetit. Manifestimi i një sjellje në formë verbale, elektronike, vizuale, të shkruar ose trupore (fizike) ndaj një individi ose grupi individësh që ka të ngjarë të provokojë/rezultojë në një reagim negativ, dëmtues dhe në një stres mendor ose emocional. Kjo sjellje mund të përfshijë:
- a) Kërcënimin direkt ose të nënkuptuar me pasoja në ushtrimin e aktiviteteve universitare të anëtarit/ve tjerë të Universitetit dhe organizatave;
 - b) Pengimin/ndërrhyrjen e pajustificuar në aktivitete shkollore dhe universitare, aktivitete personale të anëtarëve të tjerë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: sjellje/komunikime që ndërhyjnë ose pengojnë punën e mësimdhënësit në sallë, në laborator, praktikë profesionale, ose aktivitete të lidhura direkt me mësimin, udhëzimin dhe këshillimin akademik, si dhe shërbimet mbështetëse në të gjithë komunitetin e Universitetit.
 - c) Krijimin e një situatë frikësuese ose poshtëruese, shkaktimin e dëmeve personale, sociale, akademike, psikologjike, emocionale, ose stresi të panevojshëm.
- 1.17. Pjesëmarrja ose organizimi në aktivitete bastesh brenda mjediseve të Universitetit është e ndaluar.
- 1.18. Pjesëmarrja në protesta, trazira ose aktivitete që pengojnë funksionimin normal të Universitetit dhe/ose shkelin të drejtat e të tjerëve, si dhe udhëheqja ose nxitja që anëtarët e tjerë të prishin aktivitetet normale të Universitetit.
- 1.19. Shkelja e rregulloreve ose politikave të përcaktuara nga Universiteti të cilat përfshijnë: përdorimin e paautorizuar ose dëmtimin e pajisjeve kompjuterike; Vjedhja ose tentativa për vjedhje e pronës dhe/ose shërbimeve të Universitetit; posedimi dhe transportimi i vetëdijshëm i pasurisë së vjedhur; përdorimi ose konvertimi i papërshtatshëm i pronës së një tjetri për përdorim personal, kjo nënkupton edhe vjedhjet e identitetit.



- 1.20. Hakmarrja ose përndjekja e drejtëpërdrejt ose jo pas marrjes së ndonjë vendimi kundrejt anëtarëve të Këshillit të Etikës ose organi tjetër të përfshirë në çështje. Përndjekja është përkufizuar si ndjekja dhe ngacmimi i qëllimshëm, dashakeqës dhe i përsëritur i një personi që shkakton ndjenjën e frikës, kërcënimit, ngacmimit ose dhunës. Përndjekja është sjellja e një studenti i cili mban një qëndrim të përsëritur ndaj një personi tjetër dhe krijon një kërcënim të besueshëm me qëllim frikësimin për sigurinë e tij ose familjes së tij. Përndjekja mund të jetë fizike ose në adresat elektronike zyrtare.
 - 1.21. Tentativa për të kryer aktet e lartcekura ose bashkëpunimi në kryerjen e akteve të lartcekura është e ndaluar.
2. Shkelje të rënda të Kodit të Etikës konsiderohen gjithashtu veprimet e studentëve, si në vijim:
- 2.1. Dhënia e shënimeve jo të sakta të organeve të Universitetit, me qëllim të përvetësimit të drejtave të caktuara të studentëve;
 - 2.2. Tjetërsimi dhe/ose përmirësimi i shënimeve në dokumentet e lëshuara nga Universiteti;
 - 2.3. Nxitja dhe/ose pjesëmarrja në incidente në objektet e Universitetit ku pengohet zhvillimi i proceseve akademike, administrative dhe proceseve tjera;
 - 2.4. Nxitja dhe përfshirja në sjellje abuzive ndaj personelit akademik, administrativ, studentëve dhe palëve tjera që gravitojnë në Universitet. Sjellja abuzive është çdo formë apo përpjekje për të ushtruar dhunë fizike ndaj të tjerëve, kërcënimet, komentet dhe ofendimet rreth orientimit seksual, moshës, nevojave të veçanta (paaftësisë), religjionit, përkatësisë etnike;
 - 2.5. Ndalimi ose pengimi i organizimit të procesit mësimor (ligjërata, ushtrime, kolloqfime, provime dhe lloje tjera të mësimit dhe vlerësimit);
 - 2.6. Ndërhyrje ose pengim i veprimtarive akademike, administrative, sportive, sociale, kulturore ose aktiviteteve të tjera të Universitetit;
 - 2.7. Huazimi apo dhënia në shfrytëzim të ID kartelës, passwordit të emailit të universitetit dhe mjeteve tjera identifikuese, studentëve apo personave tjerë fizik;
 - 2.8. Përdorimi i paautorizuar i mjeteve dhe resurseve të universitetit;
 - 2.9. Fotokopjimi, fotografimi, inqizimi dhe shpërndarja e paautorizuar e orës mësimore, materialit për përgatitje të provimit dhe afatit të provimeve, testeve etj;
 - 2.10. Dorëzimi në vlerësim i punimeve, seminareve, projekteve dhe detyrave me plagjiaturë;
 - 2.11. Dorëzimi në vlerësim i punimeve, prezentimeve, projekteve hulumtuese me rezultate të falsifikuara/të sajuara;
 - 2.12. Fshehja dhe ndihma e studentëve tjerë në kryerjen e shkeljes disiplinore;
 - 2.13. Çdo veprim ose mosveprim që çënon ose dëmton integritetin e Universitetit ose partnerëve të tij, ose që dëmtojnë ose kanë potencialin të dëmtojnë marrëdhëniet e Universitetit me komunitetet e tij;



- 2.14. Çdo shkelje sipas marrëveshjeve, kodeve, kontratave, politikave dhe procedurave të tjera të Universitetit;
- 2.15. Çdo sjellje që çon në një hetim penal ose që përbën një vepër penale;
- 2.16. Mosrespektimi i ndonjë kërkese ose ndëshkimi të vendosur më parë sipas rregulloreve në fuqi;
- 2.17. Veprime ose mosveprime që kërcënojnë apo çenojnë shëndetin ose sigurinë e studentëve dhe stafit;
- 2.18. Aktivitete tjera të cilat nuk janë përmendur në këtë Kod, por konsiderohen si shkelje me aktet tjera të aprovuara në nivel Fakulteti dhe Universiteti;
- 2.19. Secili veprim që fyen rëndë integritetin e Fakultetit/Universitetit, personelit akademik dhe jo akademik.

Neni 9

Sjelljet joetike dhe shkeljet e lehta të studentëve

1. Shkelje e lehtë e Kodit të Etikës nga studentët konsiderohet:
 - a) sjellja jo e mirë dhe e pahijshme në objektet të Universitetit/Fakultetit, ku mbahen ligjëratat, ushtrimet dhe provimet dhe aktivitete të tjera;
 - b) prishja e rendit dhe qetësisë gjatë ligjëratave në të cilën pengohet puna normale e mësimdhënësit dhe studentëve;
 - c) shkatërrimi i paqëllimshëm i pajisjeve mësimore, laboratorëve, kompjuterëve, fondit librar në biblioteka, dhe pasurisë tjetër në Universitet;
 - d) pjesëmarrja në tubime në objektet e Universitetit për të cilat nuk ka leje;
 - e) kryerja e aktiviteteve tjera me të cilat shkaktohen pasoja të lehta dhe i çënohet autoriteti i Universitetit, personelit akademik dhe administrativ, bashkëpunëtorëve, punëtorëve tjerë dhe studentëve të Universitetit.

Neni 10

Raporti i studentëve me Universitetin/Fakultetin

1. Studentët duhet të gëzojnë të drejtat e tyre në raport me Universitetin si dhe janë të obliguar të kujdesen për resurset e Universitetit. Studentët duhet të jenë të kujdesshëm në veprimet e tyre publike në raport me Universitetin.

Neni 11

Raporti i studentëve me personelin akademik dhe administrative

1. Studentët duhet të kërkojnë që personeli akademik dhe administrativ të kryejë detyrat e tyre.
2. Studentët dhe personeli i Universitetit janë të obliguar të mbajnë raporte zyrtare njëri me tjetrin, përgjatë gjithë kohës.



3. Komunikimi elektronik në mes studentëve dhe personelit akademik dhe administrativ duhet të realizohet vetëm përmes emailit zyrtar dhe atë brenda orës 08.00 deri 20.00.
4. Ndalohet çdo formë e komunikimit mes studentëve dhe personelit akademik dhe administrativ përmes rrjeteve sociale, telefonit apo aplikacioneve të tjera, përveç në raste urgjente dhe atë vetëm për përfaqësuesit e Parlamentit Studentor.

Neni 12

Sjelljet etike të studenteve në punën shkencore dhe kumtuese

1. Studentët e Universitetit janë të lirë të ushtrojnë aktivitete shkencore, hulumtuese dhe akademike në hapësirat e Universitetit dhe në emër të tij.
2. Studentët janë të obliguar që të respektojnë rregullat etike të hulumtimit shkencor dhe të ndershmërisë akademike.

Neni 13

Shqiptimi i masave disiplinore dhe procedurave

1. Procedurat dhe masat për shkeljet e lehta dhe të rënda të Kodit të Etikës përcaktohen me rregullore të veçantë.
2. Shqiptimi i sanksioneve për shkeljet etike të studentëve, bazohet në veprimet dhe mosveprimet e studentëve të përcaktuara në këtë Kod të etikës.

Neni 14

Dispozitat përfundimtare

Ky Kod i Etikës hyn në fuqi, pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Prof. Asoc. Dr. Anif Murrija

Kryesues i Këshillit Drejtues

